

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË UJËSJELLËSIT

PER ZBATIMIN E PROJEKTIT

“ NDËRTIM UJËSJELLËSI PËR FSHATRAT KUÇ DHE POLOSKË, BASHKIA DEVOLL”.

Zbatimi i punimeve të ujësjellësit në projektin:

“NDËRTIM UJËSJELLËSI PËR FSHATRAT KUÇ DHE POLOSKË, BASHKIA DEVOLL” duhet të jetë në përshtatje të plotë me KTZ (Kushtet Teknike të Zbatimit).

Përshkrimi i Punëve

Zona e projektit është e vendosur në qarkun e Korçë, Bashkia Korçë.

Njësia Administrative Bulgarec

Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm në njësinë Administrative Bulgarec përfshin ndërtimin linjave të transmetimit dhe shpërndarjes për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, me tubacione HDPE me kaseta individuale ku instalohen matësat e ujit për secilin konsumator.

Shënim i rëndësishëm:

Kontraktori duhet të ekzekutojë të gjithë studim topografike dhe profilet gjatësore dhe do të paraqesin dokumentet e përmendura më lart tek inxhinieri para fillimit të punimeve.

Vëllimet e punimeve do të maten dhe do të vlerësohen. Kontraktori nuk ka të drejtë të ankohet për zbatimin e volumeve të punës. Kontraktori kupton plotësisht dhe bie dakort se nuk ka të drejtë për ndryshimin e çmimit njësi të punës për shkaqe që nuk janë parashikuar saktë ose të anullojë punimet.

Kerkesat e specifikimeve

Kontraktori do të përmbushin të gjitha kërkesat dhe detyrimet e të gjitha dispozitave të zbatueshme të specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të ndërtimit të punimeve të përfshira në kontratë. Për çmime që nuk janë të përfshira në preventivin e tenderit do të ndërtohen analiza sipas ligjeve në fuqi dhe do të përfshihen në situacionet e punimeve. Volumet e treguara në preventiv janë vlerësime dhe mund të ndryshojnë gjatë rrjedhës së punës. Pagesa për sasitë do të bëhet mbi punën aktuale bërë gjatë ndërtimit dhe në përputhje me metodat e matjes dhe pagesës.

Vizatimet

Te gjitha Punimet do të jene ne perputhje ne kuota , dimensione dhe detaje sipas Vizatimeve dhe në vizatimet tjera që mund të furnizohen kohe pas kohe, te miratuara nga inxhinieri. Të gjitha Kuotat ose nivelet e treguara në vizatime i referohen kuotave relative kontraktori nuk ka te drejte te beje ndryshime te projektit kur keto te fundit nuk jane te miratuara nga inxhinieri. Kontraktori do te të kontrolloje me kujdes vizatimet dhe do të verifikojë dimensionet dhe kuotat ne vend dhe do të paraqese inxhinierit ndonje

mosperputhje qe mund te gjeje aty, dhe inxhinieri do të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për korrigjim. Dështimi për të zbuluar ndonjë gabim apo mospërputhje në vizatimet, nuk e cliron kontraktuesin nga përgjegjësia apo nga detyrimi për të ndrequr dhe duke e bërë mire punën me shpenzimet e veta qe te jete plotesisht e aprovueshme nga inxhinieri.

Vizatimet Faktike As-Built

Pasi puna është e përfunduar, por para se dorëzimi i punës eshte bere te punëdhënësi , Kontraktuesi duhet t'i paraqesë vizatimet faktike të punimeve të zbatuara tek Inxhinieri . Vizatimet duhet të përfshijë te gjitha punimet e kryera dhe detajet sic ato ne te vertete jane ndertuar dhe do te kene te njejten pamje (shkallë, informacione etj) si vizatimet e Projektit.

KUSHTE DHE KRITERE TË PËRGJITHSHME

Tubat do të furnizohen në komplet së bashku me bashkuesit dhe shtesa të tjera të nevojshme.

Kanalet e tubacioneve, shtratimi dhe mbulimi janë përshkruar në kapitujt e tjerë.

Përveçse modifikuar ose shtuar si këtu, të gjitha tubat Polietilenit do të plotësojnë standartet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Te gjitha tubat do te kene te shenuara ne trupin e tyre ne menyre permanente karakteristikat e kerkuara:

-Materialin e tubit, diametrin, presionin e punes, emrin e prodhuesit etj.

Shënimi duhet të jetë i trupëzuar në tub ose i shkruar me bojë rezistente ndaj ujit.

Standardet (Referencat)

Standardet e referencës janë ato shqiptare dhe standardet e vendeve të Bashkimit Europian EEC që konsiderohen si ekuivalente.

Sidoqoftë Sipërmarrësi për standardet që ai mendon të përdorë duhet më parë të bjerë dakord me Supervizorin përpara fillimit të punimeve.

Materialet dhe paisjet do te jene sipas standarteve kombetare ose nderkombetare te aprovuara.

Te gjitha materialet dhe komponentet perberese do te jene te certifikuara sipas standarteve Shqiptare dhe te gjitha prodhimet do te jene konform Standarteve Kombetare te ngjashme ose Kodet Praktike. Kontraktori mund te propozoje standarte alternative kombetare te alernativave te propozuara te cilat duhet t'i paraqiten Supervizorit per rishikim dhe aprovim. Nje kopje e te gjithe standarteve te aprovuara do te mbahen ne Kantier nga Kontraktori. Neqoftese nuk ka Specifikime te Standarteve te publikuara, materialet dhe prodhimet do te jene nga standartet me te mira te pershtatshme dhe do te jene subjekt per aprovim nga Supervizioni. Kur punimet e propozuara lidhen me rrjetet ekzistuese materialet e reja do te jene te pershtatshme me ato ekzistueset.

Inspektimi i Vendit

Para përgatitjes për të filluar punimet (nëse kërkohet) Kontraktori do të vizitojë Objektivin dhe do të verifikojë gjendjen aktuale në krahasim me vizatimet e përgatitura, duke kontrolluar të gjithë dimensionet e rëndësishme, rruget e hyrjes, gjendjen e objektit dhe kërkesat në mënyrë që të sigurohet se të gjithë materialet dhe fuqia punëtore do të arrijnë plotësisht sipas parashikimit të vizatimeve dhe Kontrates.

Përpara fillimit të punës Kontraktori do të ekzaminojë dhe të bëjë organizimin me Supervizionin që paisjet të instalohen pa ndërhyrje me punët në vazhdim të konstruksionit dhe mund të shpërndajë në vend të gjitha materialet e listuara të kërkuara.

Kontraktori do të instruktrohet nga stafi i Supervizionit, për të marrë përgjegjësitë në të gjitha ceshtjet dhe gjerat që kanë të bëjnë me operimin, rregullimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve dhe materialeve në kushte të përshtatshme.

Mbrojtja e shërbimeve dhe e veprave ekzistuese

Kontraktori do të njihet me pozicionin e të gjithë shërbimeve ekzistuese të tilla si rrjeti i kanalizimeve, lidhjet e banesave, sistemet ujëtare, drenazhet dhe kanalet e kullimit të ujërave sipërfaqësore, kabllat elektrike dhe të telefonit, shtyllat telefonike dhe të ndriçimit, tubacionet dhe të ngjashme me to përpara se të fillojë ndonjë gërmim ose punë tjetër që mund të ndikojë këto shërbime. Kontraktori do të konsiderohet përgjegjës për demtimet e veprave dhe shërbimeve ekzistuese, dhe do të çdemtojë Punëdhënesin për çdo ankese në lidhje me këto (duke përfshirë humbjet që pasojnë). Kontraktori do të jetë përgjegjës për risjelljen në gjendjen e mëparshme të shërbimeve që janë ndikuar.

Në të gjithë rastet kur këto vepra ose shërbime janë ekspozuar, ato duhet të mbrohen në mënyrë të përshtatshme, mbeshteten ose mbrohen në ndonjë mënyrë tjetër.

Kujdes i vecantë duhet ushtruar në mbushjen dhe ngjeshjen e tokës në tubacionet kryesore të rrjetit të kanalizimeve, kabllot, kanalet ujëtare etj. Gjithë kostot që mund të rezultojnë nga Kontraktori si rezultat i punës programuese koordinuese për të bërë të mundur të bëhet çdo ndryshim këtyre shërbimeve, dhe kosto e çdo masë parandaluese do të gjykohen nga Supervizori nëse është e nevojshme, në saj të afërsisë së veprave nga çdonjëra nga shërbimet e kontraktorit. Disa nga detajet e kryqezimeve me infrastrukturen e lartpërmendur do të japin me vizatime.

Shmangia e shërbimeve ekzistuese

Mënyrë e pasigurtë është e bërë e njohur, kontraktori do të jetë përgjegjës për organizimin, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, për levizjen ose alterimin (ndryshimin) e shërbimeve ekzistuese të tilla si linjat elektrike dhe telefonike, linjat kryesore të kanalizimeve, tubacionet, kanalet ujëtare, dhe drenazhet e ujit sipërfaqësor, të cilat ndikohen nga vepra. Organizimi për një levizje ose alterim (ndryshim) të tilla do të jetë me kusht të rënies dakord me Supervizionin dhe me autoritetet përkatëse në zërat e

çmimeve te preventivit; ne kete kuader devijimi i sherbimeve ekzistuese nuk do te jete subjekt i ndryshimit te çmimit total te kontrates.

Te gjitha materialet, punimet e tokes, shtrimi, lidhjet dhe rakorderite dhe prova e tubacioneve do te plotesojne me detaje te gjithe kerkesat e ketij Specifikimi Teknik.

Te gjitha materialet duhet te jene te reja dhe te paperdorura.

Te gjitha tubat dhe rakorderite duhet te jene te inspektuara me kujdes, ne kohen qe arrijne ne objekt nga Kontraktori. Cdo material me difekt duhet te vendoset menjane per inspektim nga Supervizori; ato duhet ose te riparohen ose te zevendesohen sipas instruksionit te dhene nga Supervizori

Te gjithe difektet do te jene te identifikuara dhe do te riparohen me shpenzimet e Kontraktorit.

TUBACIONET

Te pergjithshme

Punimet kryesore qe do te kryhen ne kuadrin e ketij projekti do te jete instalimi i tubacioneve HDPE 160mm, 110mm, 90 mm, 63 mm dhe 25 mm RC PN 16.

Tubacioni do te jete i instaluar nen toke ne nje thellesi qe varion nga 1.0 m ne 1.2m dhe do te jene te mbuluar me rere te bute ne nje lartesi deri 20cm (*kjo e detyrueshme per shkak dhe te terrenit shkembor te zones*).

Te gjitha tubat do te kene te shenuara ne trupin e tyre ne menyre permanente karakteristikat e kerkuara:

-Materialin e tubit, diametrin, presionin e punes, emrin e prodhuesit etj.

Specifikime per tubacionin HDPE 110 mm, 90 mm, 63 mm dhe 25 mm RC, PN 16 dhe PN20 për linjat e transmetimit me presion. PN10 për linjat e transmetimit pa presion.

Tubacionet do te jene me material HDPE dhe diametra 160mm, 110 mm, 90 mm, 63 mm dhe 25 mm RC, PN 16 te cilet kane rezistence me te madhe për carjet nga sforcimet.

Materiali qe do te perdoret per prodhimin e tubacionit duhet te jete sipas standardeve shqiptare ose standardeve nderkombetare ekuivalente te ketyre standardeve.

Bashkimi i tubacioneve kerkohet me elemente lidhes me elektrofuzion.

Kontrolli i cilësisë së prodhimit

Prodhimi i tubave HDPE është një proces i vazhdueshëm, nevojat e të cilit kushtëzojnë dhe perfeksionojnë kontrollin, si të materialeve, ashtu edhe të fabrikimit të tyre për të arritur cilësinë e kërkuar. Një shkallë e kontrollit cilësor e testeve të përshkruara sipas standarteve përkatëse, duhet të zbatohet brenda qëllimit të një sistemi të sigurimit cilësor në përputhje me standartet e kërkuara.

Normalisht këto procedura kontrolli përfshijnë:

- Testimin e cilësive të materialeve për prodhim, si p.sh përbërja bazë.
- Kontrollin mbi uniformitetin dhe qëndrueshmërinë e granuliteve.
- Kontrollin e parametrave të prodhimit në lidhje me Temperaturën, presionin, shkallën e qarkullimit, shpejtësinë e tërheqjes dhe kapacitetin e energjisë.
- Inspektim vizual i tubave, për të kontrolluar pamjen e përgjithshme, përputhjen dimensionale dhe ndonjë tregues shtesë ose gabime të bëra gjatë prodhimit të tubave dhe lidhjet e tyre tek fundet.
- Testime afatshkurtra të prodhimit, për të identifikuar ndonjë devijim gjatë procesit të fabrikimit gjatë prodhimit.

Testimet esenciale afatshkurtra të kontrolleve cilësore përfshijnë si më poshtë:

- Kushtet e pamjes dhe të sipërfaqes
- Dimensionet
- Stabilitetin termik
- Gjatësinë në thyerje
- Presionin hidrostatik deri në 80' C
- Testin e shkurtër të trysnisë.
- Efektin në cilësinë e ujit
- Rezistencën ndaj motit
- Testim afatgjatë të presionit hidrostatik
- Rezistencë ndaj çarjeve të kryera nga ushtrimi i forcave
- Fuqia e tensionit, të tubit dhe lidhjeve në skaje.

Rakorderite

Keto pjese do te furnizohen me paketime te vecanta. Ato do te kene karakteristika te njejta fizike dhe kimike me tubat. Bashkuesit mund te prodhohen sipas formave me derdhje nese nuk gjenden ne treg, ato mund te realizohen nga tuba te drejte me prerje te nevojshme, dhenien e formes, me ngrohje (brryl, saldime me pjese speciale ose duke shtuar materiale etj.).

Ne cdo rast veprimet e mesiperme do te kryhen nga staf i specializuar me pajisjet e duhura te oficines se furnitorit.

Transporti i tubacioneve

Ne pergjithesi tubat sigurohen me gjatesi nga 6 deri 12 m, ose sic mund te arrihet dakord nga Kontraktori dhe Furnizuesi. Gjate transportit tubat do te shtrihen mbi nje siperfaqe te sheshte dhe nuk mund te dalin shume jashte nga baza e ngarkeses. Tubat ne rulon do te transportohen duke u mbeshetur horizontalisht.

Ngarkesa do te fiksohet duke perdorur gome, najlon ose litar kerpi per te shmangur kontaktin ndermjet tyre dhe tubave, me qellim shmangien e cdo gerryerje ose demtimi.

Ngarkimi, shkarkimi, dorezimi dhe stivimi

Nqs ngarkimi dhe shkarkimi nga mjetet e transportit si dhe dorezimi behet me vinc ose eskavator tubat duhet te fiksohen dhe ngrihen ne pjesen qendrore te tyre, keshtu qe ato duhet te jene gjithmone te mire balancuara gjate operimit te dorezimit.

Nqs operimet e mesiperme behen me dore eshte e rendesishme qe te shmanget terheqja zvarre e tubave, vecanerisht mbi siperfaqe te ashpra.

Planet mbeshtetese duhet te jene te rrafshta dhe pa gure te mprehte. Tubat nuk duhet te vendosen njeri mbi tjetrin ne nje lartesi me te medhe se 2 m, pavaresisht nga diametri qe ato kane.

Shtrimi i tubave ne kanal

Në përgjithësi, tubacionet shtrohen në kanale, në varësi të kushteve klimatike dhe të tokës në një thellësi e cila jepet në projekt (në profilin gjatësor dhe tërhor).

Karakteristikat gjellogjike të tokës dhe ngarkesa e trafikut ndikojnë në dimensionet e kanalit të tubit dhe ndikojnë gjithashtu në kapacitetin e ngarkesës që mban tubi vetë.

Gjerësia e tabanit të kanalit, kushtëzohet nga diametri i jashtëm i tubacionit si dhe nga domosdoshmëria e krijimit të një hapësire pune të dystuar (hapësira minimale e punës).

Duke ju përmbajtur të dhënave të sipërpërmendura të gjatësisë h dhe gjerësisë, fundi gropës duhet të krijojë kushtet optimale, që linja të mbivendoset në të gjithë gjatësinë e saj.

Mbishtresezimet duhet të ndahen mundësisht në mënyrë të barabartë, duke eliminuar kështu presionin e ushtruar prej tyre.

Tabani i kanalit nuk duhet të jetë i shkrihtëzuar. Nëse ky taban është i shkrihtëzuar, atëherë duhet që përpara vendosjes, ai të dystohet, shtypet ose të mbulohet me një shtresë të posaçme. Edhe sipërfaqet e shkrihtëzuara, por jo të forta duhet të ngjeshen.

Nëqoftëse kemi të bëjmë me sipërfaqe shkëmbore ose gurore duhet që fundi i kanalizimit të ngrihet të paktën 0.10 m dhe sipërfaqja të mbulohet me një shtresë pa gurë (shih Projektin). Kësaj mund ti shtrohet rërë, zhavorr i imët ose tokë e pastër dhe masa e krijuar ngjeshet.

Thellësia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacionet komunale ekzistuese (të ujit të rretit Elektrik, telefonik, të ujrave të shiut etj). Në rrugët me trafik të rëndë nuk rekomandohet që tubat të shtrohen me mbulim më të vogël se 1.0 m. Ne raste të tilla mund të propozohet një veshje me beton.

Thellësia e lejuar e hapjes së seksionit të kanalit jepet në projekt.

Duhet bërë kujdes që fundi i kanalit ku do të shtrohen tubat të jetë i rrafshët, pa gurë dhe mjaft i fortë. Në qoftë se në gërmimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atëherë 20 cm-at e fundit duhen gërmuar me krah.

Kërkesat e mëposhtme janë bazë dhe duhen marrë parasysh nëse duam të shtrijmë tubat

Në përputhje me standartet:

- përdorimi i një stafi të specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate, shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- pranim i rregullt deri në testin e sterilizimit

- përpilimi i dokumentacionit teknik/azhurnimi

Vetëm nëse ka përrputhje me këto kërkesa bazë, tubacioni i instaluar do të funksionojë në mënyrë perfekte, për atë kohë sa është parashikuar.

Prova e tubave me presion

Kontraktori do të sigurojë të gjithë ujin, rakorderite, saracineskat, pompat e proves, aparatit e presionit dhe krahe pune dhe veglat e punës të nevojshme për provat e tubacioneve. Pajisjet e proves duhet të jenë mbajtur në rregull dhe të kalibruara me aprovimin e Inxhinierit. Provat duhet të jenë të aplikuar në seksione të ndryshme të tubacioneve; gjatesite e këtyre seksioneve do të përcaktohen në marrëveshje midis Inxhinierit dhe Kontraktorit.

Presioni i tubacioneve do të garantohet pas karikimit të tubave duke përdorur ujë prej një burimi të aprovuar, në një presion 1 ½ here më shumë se maksimumi i presionit normal të punës. Fundi i seksionit që do të testohet do të jetë i mbyllur, duke përdorur pjesë të posaçme të ankoruara në mënyrë të përshtatshme. Tubacioni duhet të jetë mbushur me ujë në mënyrë të ngadaleshme, dhe do të jetë nën vëzhgim për ndonjë rrjedhje gjatë 24 orëve. Nëse nuk ka ndonjë rrjedhje, presioni do të rritet gradualisht deri në presionin e kërkuar të proves dhe do të mbahet në këtë presion për një minimum prej 4 orësh, për të lejuar një inspektim të detajuar nga Supervizori. Për 2 orët e tjera më pas, humbjet e ujit, do të rregjistrohen. Vlerat e humbjeve nuk duhet të kalojnë sasinë 0.1 litra/s për kilometër (Nëse cdo 1 km gjatësi linje nuk duhet të humbasim më shumë se 0.1 l/s nga vlera e prurjes së projektimit).

Të gjithë difektet do të jenë të identifikuar dhe do të riparohen me shpenzimet e Kontraktorit. Pas riparimeve të defekteve testi do të përsëritet deri sa të merret një rezultat i kënaqshëm.

Bashkimi me elektrofuzion

Manikotat me elektrofuzion kanë disa priza që përmbajnë tela nxehës elektrike të cilat kur lidhen me tensionin puthisin manikotën në tub pa pasur nevojën e pajisjeve të tjera nxehëse. Është esenciale që punëtorët të kujdesen veçanërisht për të siguruar procedurat e saldimit të respektohen rigorozisht dhe në veçanti që:

-Skajet e tubave të jenë të lëmuar ashtu si duhet.

Pastrimi dhe sterilizimi

Tubat me presion do të pastrohen me tampon e me shkumë tamponuese; pastrimi do të vazhdojë deri sa uji të dalë i pastër. Gjate ndertimit, të gjithë tubacionet do të mirembahen në kushte të pastra dhe tapa druri ose të tjera mbyllje të aprovuara do të futen në tubat e hapur në fund të cdo dite.

Tubacionet për furnizimin me ujë do të jenë të sterilizuara pas pastrimit dhe para përdorimit.

Tubacionet do të mbushen me ujë të pastër me klor mbetës në sasinë 50 mg/l; kjo mbetje mund të arrihet prej shtimit të përberjes së klorit ose klor gaz në ujë të mbushur. Tubacioni duhet të jetë i mbushur për një periudhë prej 12 orësh dhe testi i klorit do të

kryhet ne 5 (pese) mostra te ujit te marra ne piken me te larget nga pika e aplikimit te klorit. Ne se klori i mbetur ne te gjitha mostrat eshte ne nje shkalle 10 mg/l, atehere tubacioni do te konsiderohet i sterilizuar. Uji perfundimtar do te futet ngadale ne te njejten kohe si uji i pasur me klor ka terhequr papastertine. Uji i papaster do te shkarkohet ne nje rrjedhje uji te afert ose kanal kullimi te afert, te miratuar nga Supervizori.

MATESAT DHE PJESET SPECIALE

Saracineska dhe rakorderi speciale

Saracineskat jane pajisje te veçanta qe do te perdoren per kontrollin e rrjedhjes ne tubacionet e ujit. Me ane te saracineskave mund te ndryshohet madhesia e prurjes qe i jepet pjeses tjetër te tubit ose ndërprerjen e plotë të rrjedhjes. Saracineska jane me mbeshtjelles metalik me volant gize me aks prej inoksi dhe fllanxha.

Saracineskat perbehen prej pjesëve te mëposhtme:

-Trupi cilindrik prej gize ose bronxi. Në këtë trup duhet të fiksohen fllanxhat perkatëse, të cilat shërbejnë për lidhjen e saracineskës me tubacionin e rrjetit.

-Disku ose sfera i cili duhet të sigurojë mbylljen dhe hapjen e saracineskës. Ato janë me material çeliku ose bronxi dhe duhet të jenë rezistente ndaj korrozionit, goditjeve mekanike, etj

-Volanti apo leva, e cila lidhet me boshtin e rrotullimit dhe realizon hapjen ose mbylljen e diskut nëpërmjet lëvizjes vertikale rrotulluese.

-Kapaku i i saracineskës, i cili lidhet me ane të bullonave dhe dadove me trupin cilindrik të saracineskës ose me filetim.

Në vendin e bashkimit të saracineskës me tubat duhet të vendosen guaino gome në tipet me fllanxha ose fije lini dhe bojë kundra ndryshkut ose pastë, për ato me fileto, për të mos patur rrjedhje të ujit.

Saracineskat që perdoren duhet të përballojnë një presion 1,5 herë më tepër se presioni i punës. Ato duhet të përballojnë një presion minimal prej 10 atm.

Saracineskat duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë ndaj agjentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshtë riparimi dhe transporti, jetëgjatësi mbi 25 vjeçare dhe qëndrueshmëri ndaj goditjeve mekanike.

Matesat e ujit mekanik

Matesit e ujit do te instalohen ne cdo banese cdo konsumator qofte kjo per objekte banimi, sherbimi, qofte per objekte industriale. Çdo objekt do të ketë matësin e tij.

Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 dhe ISO 14001.

Të gjithë matesat mekanik duhet të kenë deklaratën e konformitetit.

Miratimi i ujit të pijshëm nga një organ i njohur ndërkombëtar ose kombëtar.

KËRKESAT TEKNIKE :

- matës mekanik
- Për lidhje aksiale
- Për instalim në kutinë plastike nëntokësore
- Xhami special me mundësi për montim të drejtpërdrejtë me vidhosje
- Kundër rrotull: 8-shifra (5 e zeza, 3 e kuqe), 1 tregues i rrjedhës.
- Trup i bërë nga polimer ose i përbërë.
- Me mbulesë mbrojtëse të bërë nga plastika e veçantë

Prurja nominale [Q _s]	2.5
Prurja fillestare [l/h]	≤ 2
R (Q _s /Q _i)	≥160
Temperatura	T 30
Humbjet e presionit	ΔP 0.63bars
Temperatura e operimit [°C]	deri në +30
Presioni nominal PN [bar]	16
Diapazoni i leximit	0.001 l ... 99,999 m ³

Pjesët speciale

Te gjitha pjeset speciale: saracineska, pjese cmontuese, T-i, reduksione, brryla, etj. do te jene me fllanxha dhe do te instalohen ne puseta. Tubacionet brenda ne pusete deri ne minimumi 50 cm ne dalje nga muret e pusetes do te jene prej celiku, lidhjet e tubacioneve te celikut me tubacionet HDPE 90 RC do te behet me fllanxha adaptor.

PUNIME GERMIMI

Te pergjithshme

a) Gërmimi duhet të kryhet në përputhje me nivelet dhe vijën e prerjeve siç tregohet në Vizatime.

b) Përmasat e prerjeve duhet të jenë në përputhje me detajet e seksionet tërthore tip. Të gjitha sheshet ku do të gërmohet, do të pastrohen nga të gjitha shkurret, bimët, ferrat, rrënjët e mëdha, plehrat dhe materiale të tjera sipërfaqësore. Të gjithë këto materiale do të spostohen dhe largohen në mënyrë që të jetë e pëlqyeshme për Punëdhënësin. Të gjitha pemët dhe shkurret që janë pëcaktuar nga Punëdhënësi që do të ngelen do të mbrohen dhe ruhen në mënyren e aprovuar.

Të gjitha strukturat ekzistuese të identifikuara për tu prishur do të largohen sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve.

Gërmimi i kanaleve për tubacionet

Kanalet do të gërmohen në dimensionet dhe nivelin e treguar në vizatime dhe /ose në përputhje me instruksionet me shkrim të Mbikëqyrësit të Punimeve. Zëri i treguar në tabelën e Volumeve (Preventiv) lidhur me gërmimet, siç është largimi i materialit të gërmuar, etj. do të përfshijë kategorine III te dheut. Gërmimi me krahë është gjithashtu i nevojshëm në afërsi të intersektiveve të infrastrukturave të tjera për të parandaluar dëmtimin e tyre. Me përjashtim të vendeve të përmendura më sipër, mund të përdoren makineritë.

Gjithashtu atje ku infrastruktura rrugore nuk e lejon kalimin e makinerive do merren masa per germimin e kanalit me krahe

Perforcimi dhe veshja e germimeve

Nëse germimi i zakonshëm nuk është i mundur apo i këshillueshëm, gjatë germimeve duhet të vendosen struktura mbajtëse për të parandaluar dëmtimet dhe vonesat në punë si edhe për të krijuar kushte të sigurta pune. Sipërmarrësi do të furnizojë dhe vendosë të gjitha strukturat mbajtëse, mbulesë, trarë dhe mjete të ngjashme të nevojshme për sigurimin e punës, të publikut në përgjithësi dhe të pasurive që janë pranë. Strukturat mbrojtëse do të hiqen sipas avancimit të punës dhe në mënyrë të tillë që të parandalojnë dëmtimin e punës së përfunduar si edhe të strukturave e pasurive që janë pranë. Sapo këto të hiqen të gjitha boshllëqet që mbeten nga heqja e këtyre strukturave duhet të mbushen me kujdes dhe me material të zgjedhur dhe të ngjeshur. Sipërmarrësi do të jetë krejtësisht përgjegjës për sigurimin e punës në vazhdim, të punës së përfunduar, të punëtorëve, të publikut dhe të pasurive që janë pranë. Kostoja e përforcimit dhe veshjes së germimeve është përfshirë në çmimin njësi për germimet.

Heqja e materialeve te teperta nga germimi

I gjithë materiali i tepërt i gërmuar nga Sipërmarrësi do të largohet në vendet e aprovuara. Kur është e nevojshme të transportohet material mbi rrugët ose vende shtruara. Sipërmarrësi duhet ta sigurojë këtë material nga derdhja në rrugë ose ato vende të caktuara.

Mirëmbajtja e germimeve

Të gjitha germimet do të mirëmbahen siç duhet, ndërkohë që ato janë të hapura dhe të ekspozuara, si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës. Pengesa të mjaftueshme, drita paralajmëruese, shenja, si edhe mjete të ngjashme do të sigurohen nga Sipërmarrësi. Sipërmarrësi do të jetë përgjegjës për ndonjë dëmtim personi ose pronësie për shkak të neglizhencës së tij.

PUNIME MBUSHJE DHE MBULIMI

Punimet mbushëse do të realizohen në përputhje me përmasat dhe nivelet që tregohen në vizatime dhe/ose siç përcaktohen ndryshe me shkrim nga Mbikëqyrësi i Punimeve. Punimet do të realizohen në nivelin që të kënaqin kërkesat e Mbikëqyrësit të Punimeve. Materialet që do të përdoren për punimet mbushëse do të jenë të lira nga gurë dhe pjesë të forta më të mëdha se 75 mm në çdo përmasë, dhe gjithashtu të pastër nga përbërësa druri apo mbeturina të çdo lloji. Materiali mbushës do të ngjeshet sipas mënyrës së aprovuar. Kanalet dhe shpatet, transetë dhe mbushjet e rrugëve do të ngjeshen gjithashtu. Nëse nuk specifikohet ndryshe apo kërkohet ndryshe nga Mbikëqyrësi i Punimeve, materiali mbushës dhe mbulues do të merret nga punimet e germimeve. Nëse Mbikëqyrësi i Punimeve përcakton se materiali nuk është i cilësisë së duhur atëherë, do të përdoret material i zgjedhur i sjellë nga një zonë tjetër. Materiali i zgjedhur do të jetë homogjen dhe do të kushtohet rëndësi pastrimit nga llumrat, boshllëqet dhe çdo parregullsi tjetër.

Mbushjet dhe mbulimet do të jenë në shtresëzime të vashdueshme dhe gati horizontale për të arritur trashësinë e treguar në vizatime ose siç mund të kushtëzohet nga Mbikëqyrësi i Punimeve. Mbulimi, në punimet e mbushjes dhe mbulimit, me material sipërfaqësor, nuk është i lejueshëm. Shtresa e sipërme e fundit, e mbushjes dhe e mbulimit duhet të mbahet në gjendje sa më të sheshtë të jetë e mundur. Në vendet ku kërkohet mbushje ose mbulim shtesë, lartësia e treguar në vizatime për mbushje dhe mbulim do të rritet në përputhje me udhëzimet e dhëna.

PUNIME BETONI DHE BETON-ARME

Cimento

Cimento do të jetë cimento e zakonshme Portland, që do të jenë të dhënë nga prodhues me reputacion dhe të aprovuara nga Supervizori. Cimento duhet të silltet në objekt dhe të perdoret nga Kontraktori vetëm me marreveshje me shkrim të Inxhinierit, të bazuar në rezultatet e certifikatave të testit të marra nga një laborator i aprovuar. E gjithë cimento që për ndonjë arsye është bërë pjesërisht e bashkuar ose përmban kokrra ose çimentoja e mbrujtur do të kthehet dhe do të largohet nga objekti.

Për çdo ngarkesë cimentoje të sjelle në objekt, Kontraktori do të dorëzojë tek Inxhinieri një vertetim me shkrim ku të tregohet numri i ngarkesës, emri i prodhuesit, dhe numri i thasëve ose të enëve mbajtëse dhe një certifikatë të testit respektiv. Vertetimi duhet gjithashtu të tregojë ku ngarkesa do të ruhet në objekt. Në shpërndarjen në objekt, cimento do të ruhet në një mjedis të pershtatshëm të thatë dhe të venteluar mirë ose në silloza me mbrojtje nga uji, kjo duhet të bëhet nga Kontraktori dhe të aprovohet prej Inxhinierit.

Kujdes duhet të tregohet në sigurimin e një dyshemeje të thatë prej druri ose betoni për çdo magazinë në mënyrë që të shmangen rreziqet e demtimit të cimentos nga dyshemeja. Të gjitha thaset e cimentos do të ruhen në dysheme të thatë dhe të venteluar mirë. Cimento nuk duhet të perdoret pa lejen e Inxhinierit dhe çdo ngarkesë do të perdoret në mënyrë të vetme dhe në rend kronologjik të sjelle në kantiër, ose siç mund të drejtohet nga Supervizori. Cimento nuk do të perdoret pasi të ruhet në objekt për më shumë se 3 (tre) muaj.

Inertët

Kontraktori do të testojë kampionet siç do të kërkohet nga Supervizori. Agregatet e imta natyrisht do të jenë rera. Agregatet e trashë do të jenë gur i therruar ose, nëse aprovohet nga Supervizori, zhavorr aluvial. Agregatet do të jenë të forta, të durueshme dhe të pastra dhe nuk do të përmbajnë materiale që mund të ndikojnë keq në fortësinë dhe durueshmërinë e masës së betonit të armuar.

Magazina ku do të ruhen agregatet do të jenë të pershtatshme për të mbrojtur kontaminimin e tyre nga dheu, plehrat, gjethet, pluhuri ose të tjera materiale të demshme. Çdo agregat i kontaminuar nuk do të perdoret në punime, dhe shtresa e fundit prej 300 mm e materialeve do të perdoren vetëm në qofte se do të aprovohen prej Inxhinierit.

Agregatet e kerkuara për përdorim në ndërtim të betoneve për mbajtje uji dhe strukturat e tjera të ngjashme nuk do të absorbojnë më shumë uje se 2% e peshës së tyre në fund të provës në drenim e cila duhet të zgjase 24 ore.

Uji

Uji per betonin do te jete sipas kerkeses se standardeve te prodhimit te betonit dhe do te merret nga nje burim i aprovuar nga Supervizori.

Armimi

Shufrat e sheshta dhe te rrubullakta te hekurit duhet te kene nje minimum te pikes se rezistences ne terheqje 250 N/mm². Minimumi i kufirit te Rezistences ne terheqje duhet te jete 410 N/mm². Ne se aprovohen nga Inxhinieri, shufra te perdredhura ne te ftohte mund te perdoren prej Kontraktorit.

Te gjitha shufrat duhet te shperndahen ne zone te lidhura fort se bashku ne tufa, me gjatesi, diameter dhe numer te treguar qartesisht.

Inxhinieri do te zgjedhe monstat e shufrave te armimit per te bere proven nese te dhenat e provave nuk jane dhene nga Kontraktori. Rezultatet e nje testi te tille do te konsiderohen si rezultatet e te gjitha ngarkeses. Shufrat e armimit duhet te ruhen ne zone mbi dysHEME dhe duhet te mbrohen me materiale kunder ndryshkut, demtimeve vajit ose agjenteve te tjere shkaterrues.

Asnje shufer armimi nuk do te ngrohet para lidhjes.

Para se te vendosen fiks ne pozicion, te gjitha shufrat e armimit do te pastrohen nga koraca, ndryshku, cemento e mbetur, boja, dheu, rera ose cdo substance tjeter e cila mund te vendoset midis shufres dhe betonit. Hekuri i armimit per betonin e armuar do te fiksohet ne perputhje me punimet e detajuara sic tregohet ne vizatime dhe instruksionet e Inxhinierit. Kontraktori do te jete pergjegjes per kontrollin e te gjitha shufrave te kerkuar nga Inxhinieri dhe te jape garanci per saktesine para prerjes dhe lidhjes se hekurit te armuar. Mbulimi i betonit mbi shufrat e armimit ne asnje rast nuk do te jete me i vogel se diametri i tyre, dhe sic tregohet dhe ne vizatime, nje minimum 30mm ne pjesen e struktures jo ne kontakt me ujin dhe 40mm per betonet qe jane ne kontakt me ujin dhe per betonet ne kontakt me dheun.

Punoi:

Ing. Ilir PAPA

Ing. Thoma KOROVESHI